



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2022:184808

Datë: 08.05.2024

Numri i dokumentit: 05663054

PPP.nr.192/22

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ - Departamenti i përgjithshëm, Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari Faton Ajvazi, me sekretaren juridike Makfire Reçica, në çështjen juridike përmbartimore të kreditorit D.e.K., me seli në Prishtinë, rr "...", kundër debitorit A.G. nga fsh, Komuna e Shtimes, për pagesën e borxhit, duke vendosur për prapësimin e ushtruar nga debitori, me datë 08.05.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET në tërësi si i pabazuar prapësimi i debitorit A.G., i ushtruar kundër urdhrin për lejimin e përmbartimit P.nr.516/22, të datës 01.08.2022, i lëshuar nga Përmbartuesi Privat K.M. nga Gjilani, dhe **MBETET në fuqi** urdhri për përmbartim P.nr.516/22, i datës 01.08.2022.

A r s y e t i m

Me urdhrin P.nr.516/22, të datës 01.08.2022, Përmbartuesi privat K.M., e ka caktuar përmbartimin e propozuar nga kreditori D.e.K., kundër debitorit A.G., për pagesën e borxhit në shumë prej 750,00 euro, në bazë të aktvendimit nr.03.1.7-2022-62, të datës 13.01.2022, të lëshuar nga D.e.K., Sektori për Kundërvajtje Doganore, dhe shpenzimet e procedurës së propozimit për përmbartim, ose bllokimin e të gjitha llogarive bankare të debitorit si dhe regjistrimin, vlerësimin, sekuestrimin dhe shitjen e sendeve të luajtshme të debitorit dhe nga shuma e fituar nga shitja e sendeve të debitorit të paguhet borxhi i kërkuar nga kreditori.

Kundër urdhrin për lejimin e përmbartimit, debitori, brenda afatit ligjor, ka ushtruar prapësim, me të cilin i ka propozuar gjykatës që ta aprovoj prapësimin si të bazuar dhe ta shfuqizoj urdhrin për përmbartim.

Kreditori në përgjigjen e ushtruar me shkrim në prapësimin e debitorit, i ka propozuar gjykatës që ta refuzoj prapësimin e debitorit si të pabazuar dhe të mbetet në fuqi urdhri për përmbarim.

Gjykata i shqyrtoj shkresat e lëndës, urdhrin për përmbarim të atakuar me prapësim dhe pretendimet në prapësim të debitorit dhe vlerësoj se prapësimi i debitorit është i pabazuar dhe nuk i plotëson asnjërin nga kushtet e parapara me nenin 71, par 1, të LPP-së.

Në të vërtetë, Gjykata vlerëson se urdhri për përmbarim P.nr.576/22, i datës 01.08.2022, i lëshuar nga Përmbaruesi Privat K.M., është i ligjshëm dhe i rregullt dhe se i njëjti nuk përmban shkelje të dispozitave të procedurës përmbarimore, ngase përmbaruesi privat e ka lejuar përmbarimin e propozuar nga kreditori në bazë të nenit 29, par 1, nën par 1.2, të Ligjit për Procedurën Përmbarimore.

Sa i përket pretendimeve të debitorit në prapësim se urdhri përmbarim P.nr.516/22 i përmbaruesit privat është në kundërshtim me dispozitat e parapara me Ligjin nr.04/L-139 për Procedurën Përmbarimore, më saktësisht dispozitës së nenit 22, e cila dispozitë saktë specifikon secilin dokument i cili mund të konsiderohet i përmbarueshëm në procedurën përmbarimore e në rastin konkret në asnjë paragraf të kësaj dispozite nuk parashihet si dokument i përmbarueshëm aktvendimi i Doganës. Konkretisht dispozita e nenit 70, 71, pika 1.1, është paraparë se dokumenti në bazë të cilit është marrë vendimi përmbarues ose urdhri përmbarues nuk i ka tiparet e përmbarueshmërisë dhe dokumenti i paraqitur nga kreditori nuk është dokument i përmbarueshëm, Gjykata këto pretendime i konsideron të pabazuara dhe të paqëndrueshme sepse nga shkresat e lëndës, konstatohet se Përmbaruesi Privat K.M., urdhrin për përmbarim P.nr.576/22, të datës 01.08.2022, e ka nxjerrë në pajtim të plotë me dispozitat e nenit 22, par 1, nën par 1.2, dhe nenit 24, par 3, të LPP-së, sepse aktvendimi nr.03.1.7-2022-62, i datës 13.01.2022, i lëshuar nga D.e.K., Sektori për Kundërvajtje Doganore, konsiderohet dokument përmbarimor dhe siç vërtetohet, i njëjti është i pajisur me klauzolën e përmbarueshmërisë për përmbarueshmëri, respektivisht është i formës së prerë nga data 27.02.2022 dhe i ekzekutueshëm nga data 27.03.2022, që nënkupton se në rastin konkret janë përmbushur edhe kushtet ligjore nga neni 36, par 1, të LPP-së.

Gjithashtu, pretendimi i debitorit në prapësim se urdhri për përmbarim është lejuar në kundërshtim me ligjet në fuqi edhe nga fakti se urdhri për përmbarim është lëshuar nga Përmbaruesi privat i cili nuk ka kompetencë territoriale, për faktin se edhe selia e kreditores por edhe ajo e debitores gjenden në Prishtinë, respektivisht në Ferizaj, andaj në bazë të dispozitave

të nenit 5, par 4 dhe 5, të LPP, kompetencë territoriale ka gjykata në vendin e së cilës e debitori e ka vendbanimin, Gjykata konsideron se edhe ky pretendim nuk qëndron dhe është i pabazuar, sepse nga shkresat e lëndës, gjegjësisht nga propozimi për përmbarrim i kreditorit, konstatohet se adresa e vendbanimit të debitorit është në fsh ..., Komuna e Shtimes, dhe duke e marr parasysh këtë fakt, Gjykata konsideron se Përmbarruesi Privat drejtë ka vepruar kur e ka nxjerrë urdhrin për përmbarrim të atakuar me prapësim, respektivisht i njëjti ka vepruar në pajtim të plotë me dispozitat e nenit 323, par 4, të LPP-së, në të cilin është paraparë shprehimisht se: *“Me kërkesë të kreditorit, përmbarruesi privat mund të ndërmarr veprime për zbatimin e përmbarrimit edhe jashtë territorit për të cilin ai është emëruar, personalisht apo nëpërmes përmbarruesit privat të territorit tjetër”*. Për më tepër dispozitat e nenit 5, par 3, të LPP-së, në të cilat është thirr debitori në prapësim, i referohen kompetencës së gjykatës me rastin e vendosjes lidhur me prapësimin e debitorit, në të cilin shprehimisht është paraparë: *“Për të vendosur çështjet që kanë të bëjnë me çdo prapësim, ankesë, parregullsi në procedurën përmbarruese sipas nenit 52 dhe 67 të këtij ligji, ose çfarëdo lloj procedure kundër veprimeve të ndërmarra nga Përmbarruesi privat, kompetencë ka Gjykata kompetente në territorin e së cilës debitori ka vendbanimin apo nëse nuk ka vendbanim në Kosovë, atëherë në territorin në të cilin ka vendqëndrimin nëse është person fizik. Nëse debitori është person juridik, kompetencë territoriale ka Gjykata kompetente ku gjendet selia e debitorit. Nëse debitori nuk ka vendbanim të përkohshëm ose seli në Kosovë, kompetencë ka Gjykata kompetente në territorin e së cilës gjinden sendet e luajtshme dhe të paluajtshme e të cilat janë objekt përmbarrimi”*.

Po ashtu, sa i përket pretendimit të debitorit se propozimi për përmbarrim nuk është në harmoni me ligjin, Gjykata edhe këtë pretendim e konsideron të pabazuar sepse nga propozimi për përmbarrim i kreditorit, konstatohet se i njëjti propozimin e tij e ka përpiluar në pajtim të plotë me nenin 38, par 1, të LPP-së, sepse propozimi siç shihet e përmban kërkesën për përmbarrim në të cilën është treguar dokumenti përmbarrimor siç është aktvendimi nr.03.1.7-2022-62, i datës 13.01.2022, i lëshuar nga D.e.K., Sektori për Kundërvajtje Doganore, në origjinal, kërkuesin e përmbarrimit dhe debitorin dhe të dhënat e tyre rreth adresës së tyre, kredia që kërkohet të realizohet, si dhe të dhënat tjera të cilat janë të nevojshme për zbatimin e përmbarrimit.

Për më tepër, Gjykata vlerëson se aktvendimi në bazë të cilit është nxjerrë urdhri për përmbarrim i atakuar me prapësim është në tërësi i përshtatshëm për përmbarrim dhe në pajtim me nenin 27, par 1, të LPP-së, për arsye se në të është treguar debitori dhe kreditori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit.

Nga të cekurat më lart dhe bazuar në nenin 73, par 1, 2 dhe 3, të LPP-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ

PPP.nr.192/22, më datë 08.05.2024

GJYQTARI

Faton Ajvazi

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktvendimi mund të ushtrohet ankesë Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate, në afatin prej 7 ditësh, nga dita e pranimit të